

Kur një predhë ka rënë në oborrin e komshiut Malush Ahmetit [të shikohet regjistrimi i mëparshëm], njerëzit nga mëhalla i kaploi paniku dhe ata filluan t'i braktisnin shtëpitë. Në çastin kur Ramadanit, Elfija dhe Xufa dolën nga shtëpia, një granatë ka eksploduar në oborr. Ramadanit u qëllua për vdekje në vend, ndërkaq Elfija dhe Xufa u plagosën rëndë. Vëllai i Ramadanit, Hakiu, i mori dy vajzat e plagosura dhe i vendosi në rimorkion e traktorit me familjarë të tij të tjerë. Sapo arritën *te Mëhalla Deliu*, Elfija ndërroi jetë. Hakiu u ndal dhe e la trupin e saj në bodrumin e Sadri Velikut. Kur arritën te fshati fqinj të Makërmalit/Makrmal, ndërroi jetë edhe Xufa. Në të njëjtën mbrëmje, Hakiu e ka varrosur Xufën në lagjen *Bajriqi*, në fshatin Gradicë/Gradica [Gllgoc/Glogovac]. Vëllai i Ramadanit, Ilmiu, dhe disa bashkëfshatarë të tij e kanë varrosur Ramadanin në varrezat e fshatit, po atë ditë kur ai edhe u vra. Pesë ditë më vonë, Sadri Veliku e ka varrosur Elfijen pranë të atit Ramadanin. Pas lufte, Xufën e kanë varrosur pranë të atit dhe motrës, më 16.11.1999. godine.

**Burimet:** deklarata H.A, FDH-14434; *Serb Troops Mount Heavy Attack Against Drenica Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.09.1998, FDH-29557; *Two More Albanians Die As Serbs Continue Attacking Drenica Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 13.09.1998, FDH-29559.

### Nebojša (Živorad) Vićentijević

(19.10.1971, serb nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, student, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Nebojša ka qenë absolvent i Fakultetit Elektroteknik në Prishtinë/Priştina. Punonte në Elektro-distribucion në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Nga viti 1998, ka qenë pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së. E kanë vrarë më **12.09.1998**, rreth orës 21:30, në **Likoc/Likovac**.

**Burimet:** SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 19; KMKKRF, *Personat.*, FDH-10832; SMIP, *Terroristički.*, III, 489, 939; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini*, <http://www.srbija-info.yu/ve-sti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

### Cenë (Bislim) Gjinovci

(15.07.1930, shqiptar nga Makërmali/Makrmal, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tre fëmijë)

### Ramë (Mursel) Gjinovci

(15.04.1931, shqiptar nga Makërmali/Makrmal, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, dhjetë fëmijë)

Kushërinjtë Cenë dhe Ramë Gjinovci me familjet e veta jetonin në Makërmal/Makrmal, ku merreshin me bujqësi. Në datën 8.09.1998, forcat serbe e sulmuan fshatin. U stacionuan pranë rrugës Gllgoc/Glogovac – Skënderaj/Srbica. Familjet e Cenës dhe Ramës, së bashku me shumicën e banorëve të tjerë, e braktisën fshatin, përderisa ata që të dy ndenjen në Makërmal/Makrmal. Nga ajo ditë, familjarët e tyre nuk kishin kurrfarë njohuri për fatin e tyre. Në datën **12.09.1998**, forcat serbe e bombarduan **Makërmalin/Makrmal** dhe pozicionet e UÇK-së. Në mbrëmje, kur forcat serbe u tërhoqën, stërnipi i Ramës, Gazmendi, u kthye në fshat. Shumica e shtëpive ishte e shkrumbuar nga zjarri. Në oborrin e Ramës, i ka gjetur teshat e shkapërderdhura të stërgjyshit, por nuk kishte asnjë gjurmë të Ramës. Në të njëjtën mbrëmje, një i afërm i Ramës, Isa, e ka gjetur trupin e pajetë të Ramës në oborrin e Ali Gjinovcit, në *Mëhallën Sylaj*. Ramën e kanë varrosur një ditë më vonë në varrezat e fshatit. Trupi i Cenës u gjet më 22.09.1998, kur djali i tij Hamiti u kthye në fshat. Trupi i tij ka qenë i shtrirë në rrugë e cila çonte nga shtëpia e tij në *Mëhallën Idrizi*. Hamiti e ka varrosur trupin e të atit në të njëjtën mbrëmje në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata A.G, FDH-14935; deklarata H.G, FDH-14936; *Bodies of Three Killed Albanians Found in Drenica Today*, pasqyra e lajmeve, KIC, 27.10.1998, FDH-29780; *Two More Albanians Die As Serbs Continue Attacking Drenica Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 13.09.1998, FDH-29559.

### Goran (Dragan) Nikolić

(13.05.1972, serb nga Vlladiçin Hani, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Gorani punonte në SPB-në e Vranjes. Nga muaji mars i vitit 1998, Gorani ka qenë